

Shtojca 12.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data : 09/02/2026

Drejtuar: **OE "ALKO-IMPEX Construcion" shpk** perkatesisht me nr.Nipti: **K91628013D** dhe
adrese: **TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Asim Vokshi", Alb building 2t, kati i 2**

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

Tipi i Kontratës : Sherbime

Lloji i Procedurës së prokurimitL: E hapur mbi kufirin e lartë monetar

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]

Numri i referencës së procedurës /Lotit: **70131-11-25-2025**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **50 (pesedhjetë) muaj**

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: **“ Shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Librazhd, për vitet 2025-2029”.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **26/11/2025**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Buletini Nr. 75 datë 2 Dhjetor 2025**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.OE " Pastrime Silvio "shpk**K91413010N**

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera **124,070,992 (Njëqind e njëzet e katër milion e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) leke pa tvsh**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO xNëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. OE "REJ "shpk**J93711608Q**

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **137,560,389 (Njëqind e tridhjetë e shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) leke pa tvsh**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO xNëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. OE "ALKO-IMPEX Construcion"shpk**K91628013D**

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **136,826,030 (Njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e tridhjetë) leke pa tvsh.**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO xNëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

OE " Pastrime Silvio "shpk

K91413010N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 124,070,992 (Njëqind e njëzet e katër milion e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) leke pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Eshte skualifikuar operatori ekonomik : " Pastrime Silvio "shpk perkatesisht me nr.Nipti: **K91413010N me oferte ekonomike 124,070,992 (Njëqind e njëzet e katër milion e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) leke pa tvsh** per arsye se :

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik **“Pastrime Silvio” SHPK me NUIS: K91413010N**, me vlerë 124 070 992 Lekë (një qind e njëzet e katër milion e shtatëdhjetë mijë e nëntë qind e nëntëdhjetë e dy) , **nuk** është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 76 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë **nuk** kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit, për arsye se operatori ekonomik **“Pastrime Silvio” SHPK**, nuk plotëson kriteret e dokumenteve standarte të tenderit si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **40 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Për të plotësuar këtë kriter operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, ka paraqitur në sistemin e prokurimit publik elektronik (SPE), dokumentacionin e mëposhtëm:

- Faturat tatimore të shitjes me blerës Banka e Shqipërisë, gjithsej 30 (tridhjetë) fatura me vlerë të përgjithshme 36 269 748 (tridhjetë e gjashtë milion e dy qind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatë qind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH . Bazuar në këto fatura tatimore emërtimi i shërbimit është “Shërbim i pastrim higjenizimit dhe dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë”.

Duke qenë se informacioni i faturave tatimore nuk është i mjaftueshëm për të vlerësuar drejtë cilat janë shërbimet e realizuara, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i është drejtuar operatorit ekonomik me “Kërkesë” , në sistemin e prokurimit publik elektronik (SPE), për të kërkuar të dhëna provuese shkresore si më poshtë:

- Kontratë shërbimi dhe/ose preventiv dhe/ose situacione për faturat tatimore të shitjes me blerës Banka e Shqipërisë, me qëllim verifikimin e zërave të punimeve të kryera dhe vlerave përkatëse.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, operatori ekonomik **“Pastrime Silvio” SHPK**, ka paraqitur kontratën e shërbimit nr.2052 prot., datë 27.03.2023 , me objekt “Shërbim i pastrim higjenizimit dhe dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare”, me fond limit 15 944 176,8 Lekë. Bazuar në Preventivat dhe specifikimet teknike në këtë kontratë vetëm pastrimi i parkim, trotuare dhe oborre mundet të klasifikohet si punë e ngjashme , bazuar në tabelën nr 2 shuma totale e këtij shërbimi është 2 026 692 lekë me TVSH ose 1 718 910 pa TVSH.

Për faturat tatimore të shitjes së paraqitura , për vitet 2024 dhe 2025 , të cilat nuk përfshihen në kontratën e mësipërme, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk i merr në shqyrtim për sa kohë nga ana e operatorit ekonomik nuk janë paraqitur informacionet përkatëse, duke i konsideruar të paplota.

- **Faturat tatimore të shitjes me blerës Ambasada Amerikane me emërtim “Heqje mbeturinash”, faturat tatimore të shitjes me blerës CONAD FOOD TRADE me emërtim “Shërbim pastrimi dhe mirëmbajtje”, faturat tatimore të shitjes me blerës EM 21 SHPK me emërtim “Shërbim pastrimi dhe mirëmbajtje”, faturat tatimore të shitjes me “Salus Tirana”**

Duke qenë se informacioni i faturave tatimore nuk është i mjaftueshëm për të vlerësuar drejtë cilat janë shërbimet e realizuara, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i është drejtuar operatorit ekonomik me “Kërkesë” , në sistemin e prokurimit publik elektronik (SPE), për të kërkuar të dhëna provuese shkresore si më poshtë:

- Kontratë shërbimi dhe/ose preventiv dhe/ose situacione për faturat tatimore të shitjes me blerës Ambasadë Amerikane, me qëllim verifikimin e zërave të punimeve të kryera dhe vlerave përkatëse;
- Kontratë shërbimi dhe/ose preventiv dhe/ose situacione për faturat tatimore të shitjes me blerës CONAD FOOD TRADE, me qëllim verifikimin e zërave të punimeve të kryera dhe vlerave përkatëse;
- Kontratë shërbimi dhe/ose preventiv dhe/ose situacione për faturat tatimore të shitjes me blerës EM 21 SHPK, me qëllim verifikimin e zërave të punimeve të kryera dhe vlerave përkatëse;
- Kontratë shërbimi dhe/ose preventiv dhe/ose situacione për faturat tatimore të shitjes me blerës CONAD ALBANIA, me qëllim verifikimin e zërave të punimeve të kryera dhe vlerave përkatëse;
- Kontratë shërbimi dhe/ose preventiv dhe/ose situacione për faturat tatimore të shitjes me blerës SALUS TIRANA, me qëllim verifikimin e zërave të punimeve të kryera dhe vlerave përkatëse;

Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, operatori ekonomik **“Pastrime Silvio” SHPK**, ka deklaruar : Gjithashtu po ju informojmë se për marrëdhëniet e shoqërisë sonë me subjektet private si CONAD FOOD TRADE, CONAD Albania, EM 21 sh.p.k dhe Salus Tirana, shërbimet janë realizuar mbi bazën e kërkesave për ofertë nga ana e klientëve, ofertave të paraqitura nga shoqëria jonë dhe miratimit të tyre, pa lidhjen e një kontrate të veçantë të shkruar. Marrëdhënia kontraktore midis palëve është konkretizuar përmes kryerjes faktike të shërbimeve dhe është dokumentuar në mënyrë të rregullt përmes faturave tatimore, të cilat janë ngarkuar në sistem dhe shërbejnë si provë e ligjshme e kryerjes së shërbimeve, vlerës financiare dhe natyrës së tyre.

Duke qenë se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nuk e ka kushtëzuar operatorin ekonomik mbi emërtimin / dhe ose formën juridike të paraqitjes së informacionin plotësues/ sqarues, komisioni do të vlerësonte të vlefshme edhe paraqitjen e kërkes/ ofertave midis palëve mjafton që në to të evidentohen cilat shërbime janë përfshirë dhe vlerat përkatëse, sepse emërtimi është shumë i përgjithshëm. Duke qenë se nga ana e operatorit ekonomik nuk është paraqitur asnjë e dhënë shtesë, komisioni duke marrë në konsideratë që subjektet CONAD FOOD TRADE, CONAD Albania, EM 21 sh.p.k në adresat e deklaruara kanë supermarke të vendosura në ambiente të brendshme të godinave, pastrimin e tyre e klasifikon si pastrim të ambienteve të brendshme dhe nuk e vlerëson si punë të ngjashme me zërat e preventivit të objektit të prokurimit të cilat janë: mbledhje mbeturinash, Dezinfektim larje kontinierësh, Fshirje rrugësh, Fshirje rrugësh me Makinë ,Lagje rrugësh.

Duke qenë se nga ana e operatorit ekonomik nuk është paraqitur asnjë e dhënë shtesë, komisioni duke marrë në konsideratë që subjektet AMBASADA AMERIKANE dhe Salus TIRANA, janë godina civile pastrimin e tyre e klasifikon si pastrim të ambienteve të brendshme dhe nuk e vlerëson si punë të ngjashme me zërat e preventivit të objektit të prokurimit të cilat janë: mbledhje mbeturinash, Dezinfektim larje kontinierësh, Fshirje rrugësh, Fshirje rrugësh me Makinë ,Lagje rrugësh.

- Faturat tatimore të shitjes me QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NENE TEREZA".

Për një vlerësim sa më të drejtë dhe konform legjislacionit në fuqi Komisioni i Vlerësimit i është referuar dokumenteve standarte të tenderit të publikuara për procedurën me objekt "SHËRBIM PASTRIMI I AMBJENTEVE TË JASHTME, PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA", më konkretisht preventivit të kësaj procedure dhe ka vlerësuar si punë të ngjashme zërat : Pastrim i rrjetit rrugor + trotuare me krahë (fshesë) turni1, Pastrim i rrjetit rrugor + trotuare me krahë (fshesë) turni 2, Larje e rrjetit rrugor me ujë nën presion m2 29,485.1 240 6 Larje e shesheve me ujë nën presion, Shërbim evadimi të mbetjeve urbane QSUNT - Landfill (3-4 herë/ditë sipas kërkesë së A.K).

- Faturat tatimore të shitjes me SPITALIN UNIVERSITAR OBSTRETIK GJINEKOLOGJIK MBRETERESHA

Për një vlerësim sa më të drejtë dhe konform legjislacionit në fuqi Komisioni i Vlerësimit i është referuar secilës faturë duke vlerësuar si zë të ngjashëm Larje e rrjetit rrugor te SUOGJ.

- Faturat tatimore të shitjes me Bashkinë Prenjas

Për një vlerësim sa më të drejtë dhe konform legjislacionit në fuqi Komisioni i Vlerësimit i është referuar secilës faturë duke vlerësuar si zë të ngjashëm : Transporti i mbetjeve urbane për në inceneratorin e Elbasanit

Nga shumatorja e vlerave të zërave të klasifikuar si punë e ngjashme Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se operatori ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK nuk e plotëson kriterin punë të ngjashme në 40% të vlerës së fondin limit .

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme, **ku të përcaktohet tipi(emertimi teknik),lloji,marka,nr. i shasisë,viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si me mëposhte:**

- Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës minimal 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë;**
- Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës ton **2-5 ton**, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **2 (dy) copë;**
- Makinë transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë;**
- Makina për larjen e rrugëve, (autobot), të jetë i pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo

më pak se 5000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë;**

- e. Mjet pastrimi teknologjik për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 0.25-5 m³, pajisur me 2 (dy) fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë.**

Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën **2.3.6 , gërma a – e**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore dhe fotot perkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publike që merren me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të paraqitet leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore dhe fotot perkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.
- Për mjetet në pronësi/qera, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku autoriteti kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të tyre. Në këtë deklaratë do të jepen të dhëna të sakta të kontaktit të operatorik ekonomik si: Numër cel, adresë emaili, adresa e selisë së shoqërisë. Nga ana e autoritetit kontraktor do të dërgohet një njoftim si në adresën elektronike në SPE edhe në të dhënat e kontaktit të OE ku do të përcaktohet vendi dhe ora e verifikimit të mjeteve. Në rast se Operatori ekonomik nuk i disponon të gjitha mjetet e deklaruara në tender, ai do të s’kualifikohet.
- **Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion për të përmbushur kontratën ambient me sipërfaqe jo më e vogël se 500 m² e cila do të shërbejë si pikë për parkim për mjetet dhe të tjera. Për të provuar këtë duhet të paraqitet dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë. Në rastin kur ambjenti merret me qira duhet të paraqitet kontratë e vlefshme qiraje dhe dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë e qiradhënësit.**
- **Operatori ekonomik që paraqet ofertën duhet të disponojë një pikë për larjen dhe dizinfektimin e kazanëve (lavazh) në pronësi apo me qera (ne formën e kërkuar nga ligji, me çertifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontratë qiraje nëse është marrë me qera shoqëruar me dokumentacionin e përkatës**

Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit , Sipas Shtojcës 8, në lidhje me informacionin për mjete nuk ka deklaruar informacion të plotë. Duke qenë se informacioni nuk i është i mjaftueshëm për të vlerësuar drejtë cilat janë shëbimet e realizuara, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i është drejtuar operatorit ekonomik me “Kërkesë” , në sistemin e prokurimit publik elektronik (SPE), për të kërkuar të dhëna provuese shkresore si më poshtë:

- Kontrata e qirasë me dokumentacionin e mjeteve dhe/ose deklaratë mbi vitet e prodhimit të mjeteve dhe afatin e kontratës së qirasë për mjetet e marra me qira;
- Dokumentacionin e mjeteve dhe/ose deklarata mbi vitin e prodhimit të mjeteve në pronësi.

Në përgjigjen e tij, operatori ekonomik nuk ka paraqitur informacion mbi afatin e kontratës së qirasë së mjeteve apo vitin e prodhimit të tyre në asnjë nga format e kërkuara. Komisioni e vlerëson kriterin të paplotësuar.

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin Operatori ekonomik që paraqet ofertën duhet të disponojë një pikë për larjen dhe dizinfektimin e kazanëve (lavazh) në pronësi apo me qera (në formën e kërkuar nga ligji, me certifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontratë qeraje nëse është marrë me qera shoqëruar me dokumentacionin e përkatës.

Kontrata e qirasë e paraqitur, nr.4950 Rep., nr.1245 Kol., datë 08.09.2020, në nenin 2 “Qëllimi i përdorimit” , parashikon që prona jepet vetëm për parkim, fakt i cili përforcohet në nenin 5 paragrafi i parë ku qirramarrësit i jepet e drejta ta përdorë pronën vetëm për parkim, dhe i ndalohet përdorimi për qëllime të tjera. Për më tepër që për ambientin e larjes së kontenierëve legjislacioni parashikon pajisjen me leje mjedisore e cila garanton kryerjen e shërbimit sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga ligji, pa dëmtuar.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) vendos të skualifikojë ofertën operatorit ekonomik " Pastrime Silvio "shpk .

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE "ALKO-IMPEX Construcion" shpk** perkatesisht me nr.Nipti: **K91628013D** dhe adrese: **TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Asim Vokshi", Alb building 2t, kati i 2**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **136,826,030 (Njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e tridhjetë) leke pa tvsh** totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

PERSONI I AUTORIZUAR I TITULLARIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
BAJRAM PISHKASHI